



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/42/21

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga M.Ž, ndaj gjyqtares V.S, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafit 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafit 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 06.12.2021 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga M.Ž, ndaj gjyqtares V.S, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për të parashtruar Kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Autoriteti Kompetent i kësaj Gjykate - Kryetarja e Gjykatës A.Sh-R me datë 09.11.2021 nga pala M.Ž, ka pranuar ankesën-Kallëzim disiplinor ndaj gjyqtares V.S, për shkak të pretendimeve për shkelje që e njëjta i ka bërë gjatë procedimit të lëndës C.nr.787/2019.

Ankuesi, M.Ž, në ankesën e parashtruar ka theksuar se në zhvillimin e lëndës C.nr.787/19 sipas propozimit për caktimin e masë së sigurisë, rëndë po shkelet ligji dhe po i shkakton dëm të madh palës, për arsye se gjykata masën e përkohshme të sigurisë e ka sjell me datë 24.09.2019 pas kundërshtimit të masës së përkohshme, pas 13 muajve ka caktuar seancën për masë të sigurisë në të cilën nuk i ka ftuar palët në mënyrë të rregullt, e pastaj ka caktuar seancë me datë 25.05.2020, edhe pse bëhet fjalë për procedurë të natyrës urgjente dhe ka shkelur afatet të përcaktuar në nenin 306, paragrafin 2 të LPK-së.

Po ashtu ankuesi, ka theksuar se në lëndën C.nr.2023/07 është parashtruar kërkesë për përsëritje të procedurës, lëndë e kontestit është palujtshmëria e njëjtë dhe shkresat e kësaj lënde janë bashkuar me lëndën C.nr.787/19. Lidhur me veprimet ndaj aktvendimit C.nr.2023/2007 në këtë çështje me propozimin për përsëritje të procedurës Gjykata e Apelit në aktvendimin e datës

20.02.2019, e prish aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe lënda i kthehet të njëjtës në riprocedurë dhe vendosje, dhe gjykata nuk ka vepruar sipas aktvendimit Ac.nr.3893/2016 të datës 20.02.2019.

Në pretendime e theksuara me tutje në ankesë ka theksuar çështjen se pas kundërshtimit me datë 07.10.2019 kundër vendimit për masë të përkohshme të sigurisë, gjykata nuk ka sjellë vendim dhe seancën e radhës e ka caktuar në maj të vitit 2022 për arsye se pala Ndërmarrja Sh.K nga Beogradi nuk ka pranuar ftesën. Ndërmarrja Sh.K gjykatës ja ka dorëzuar shkresa me të cilën njofton gjykatën se nuk ka interes juridik për pjesëmarrje në këtë procedurë, duke pasur parasysh që e ka humbur kontestin. Më tej në ankesë është theksuar edhe çështja e mos dorëzimit të lëndës në Gjykatën Supreme lidhur me propozimit për caktimin e një gjykate tjetër kompetente lëndore.

Në lidhje me pretendimet e theksuar në ankesë, gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se, “ Tre (3) muaj pas ngarkimit me këtë lëndë kam caktuar seancën dëgjimore për shqyrtimin e propozimit për përsëritjen e procedurës, kjo seancë është shtyre për arsyeje se nuk ka pasur kushte që e njëjta të mbahet pasi që e paditura Sh.C. me seli në Beograd nuk është ftuar në mënyrë të rregullt, duke pasur parasysh faktin se as seanca dëgjimore lidhur me propozimin për caktim tani të masës së sigurisë, (sepse masa e përkohshme e sigurisë është vendosur), nuk mundë të mbahet pa praninë e palëve ndërgjyqëse në procedurë. Gjykata ka qenë e detyruar që në mënyrë që të mos ketë zvarritje të me tutjeme të procedurës në këtë çështje kontestimore, ta shtyjë mbajtjen e seancës për një afat më të gjatë, në mënyrë që ftesat të dërgohen dhe përgjigja nga Institucionet në shtetin Serb të kthehen brenda këtij afati. Gjykata është e vetëdijshme se seancat dëgjimore duhet të caktohet brenda afatit sa më të shkurtër kohorë, mirëpo pasi që kemi të bëjmë me të paditur i cili është jashtë shtetit të Kosovës, dhe komunikimi me shkresa me personat jashtë shtetit të Kosovës duhet të bëhet përmes rrugëve zyrtare dhe kjo çështje merr kohë më të gjatë, e ka caktuar seancën dëgjimore me datë 25.05.2021, krejt kjo me qëllim të sigurimit të palëve në procedurë ose kthimin e një përgjigje konkrete nga Institucionet e shtetit Serb, në mënyrë që mos të ketë zvarritje të mëtutjeshme të procedurës. Gjykata seancën e datës 25.05.2021, e ka shtyrë për shkak se nuk ka pasur kushte që e njëjta të mbahet, për arsyeje se për të paditurën Sh.C me seli në Beograd, nuk ka pasur prova se e njëjta është ftuar në mënyrë të rregullt. Seanca e radhës është caktuar për datë 18.04.2022 në ora 10:00h, për shkak se ftesat për seancë është dashur që të dërgohen në Republikën e Serbisë, dhe konform Udhëzimin Administrativ për Procedurën e ofrimit të ndihmës juridike ndërkombëtare në çështje penale dhe civile. Ndërsa sa i përket propozimit të bërë për caktimin e një gjykate tjetër me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje, ju informoj se është obligim i gjykatës që fillimisht pas pranimit të propozimit për përsëritje të procedurës ta shqyrtoj se kush është kompetente për të vendosur në këtë çështje juridike kontestimore. Andaj pasi që në këtë rast kemi të bëjmë me propozim për përsëritjen e procedurës ndaj një vendimi që është marrë në vitin 2007, dhe me ligjin e vjetër të Procedurës Kontestimore Neni 429, parashihet që “Propozimi për barazimin e procedurës i bëhet gjykatës e cila ka marrë vendim në shkallën e parë”. Ndërsa neni 432 parashihe që “Pas mbajtjes së shqyrtimit për diskutimin mbi propozimin, gjykata e shkallës së parë merr vendim mbi propozimin, përveç nëse arsyeja për përsëritjen e procedurës ka të bëjë ekskluzivisht me procedurën para gjykatës së shkallës më të lartë”.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarës dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për shkelje disiplinore të gjyqtarës V.S.

Autoriteti i kësaj gjykate, referuar shkresave të lëndës Gjyqtarja V.S është ngarkuar me këtë lëndë me datë 26.08.2020, dhe brenda afatit prej tre muajve ka marr veprime në këtë çështje dhe ka caktuar seancën dhe e njëjta është shty për arsyeje se nuk ka pasur kushte të mbahet pasi që e paditura Sh.C me seli në Beograd nuk është ftuar në mënyrë të rregullt. Pasi që nuk ka pasur kushte që të mbahet seanca e datës 25.05.2021, seanca e radhës është caktuar që të mbahet me datë 18.04.2022, për shkak se ftesat për seancë është dashur që të dërgohen në Republikën e Serbisë, dhe gjyqtarja konform Udhëzimin Administrativ për Procedurën e ofrimit të ndihmës juridike ndërkombëtare ka shfrytëzuar komunikimin zyrtar, pasi ka pasur të bëjë komunikimi me shkresa me personat jashtë shtetit të Kosovës. Në bazë të të dhënave të theksuara më lartë dhe për çështjen veprimeve të gjyqtarës lidhur me ftesën e palës së paditur ndërmarrjen Sh.K, Autoriteti i kësaj gjykate vlerëson se janë çështje procedurale dhe ndaj shkeljeve për çështje procedurale dhe materiale pala e pakënaqur mund të shfrytëzon mjetet juridike.

Në çështje e vendimmarrjes në lëndën C.nr.2023/2007, përkatësisht aktvendimit Ac.nr.3893/16 të datës 20.02.2019 se gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur sipas udhëzimeve të përcaktuara lidhur me aktvendimin e shkallës së dytë, për këtë çështje Autoriteti i kësaj gjykate nuk ka kompetenc për të komentuar, ndryshuar apo për të vendosur ndaj vendimeve të gjykatës, mirëpo pala e pakënaqur lidhur me vendimet e gjykatës ka të drejtën e apelit në gjykatën e instancës më të lartë.

Në çështjen e mos dorëzimit të lëndës në Gjykatën Supreme lidhur me propozimit për caktimin e një gjykate tjetër kompetente lëndore, në këtë çështje gjyqtarja në deklarimin e saj ka dhënë sqarimin për arsye se është në kompetenc të saj për të vendosur.

Në bazë të fakteve për këto çështje dhe provave të shqyrtuar nga Autoriteti i kësaj gjykate, veprimet e gjyqtarës nuk përbëjnë shkelje disiplinore, dhe nuk ka shkelje sipas dispozitave të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me parashtesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkuara më lartë vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtarja ka kryer shkelje disiplinore, për ti parashtruar KGJK-së kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
AD/GJTHPR/42/21, më datë 06.12.2021

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë